**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"BPI BLESSED PROPERTY INVEST" SH.P.K.**

Sot, me date 19/02/2025 (dymije e njezet e pese), i pranishem:

- **Z. Erald MATA**, shtetas shqiptar, lindur më 24/01/1990 në Peshkopi e banues në Rrugen "Besim Fagu", Nd. 3, H. 1, NjA nr. 4, 1012, Tirane, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. 036096570 dhe me numër personal J00124048R, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

në cilësinë e ortakut te vetem themelues shpall hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akt Themelimi në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si me poshtë vijon:

**NENI 1**
**EMËRTIMI**

Themelohet një shoqëri tregtare me përgjegjëesi të kufizuar me emërtimin "**BPI BLESSED PROPERTY INVEST**" sh.p.k.

**NENI 2**
**SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën Rruga "Kavajes", Square 21, Shk. 1, K. 6, Ap. 1, Shqipëri. Asamblea Ortakëve mund të vendose krijimin ose mbylljen e selive dytësore, filialeve, zyrave të përfaqësimit dhe degëve të shoqërisë ose transferimin e selisë së shoqerisë në qytete të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

**NENI 3**
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregetare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

**NENI 4**
**OBJEKTI**

Objekti i Shoqërisë është:

Zhvillimi i nje resorti turistik, duke përfshirë strukturën e hotelerisë, operimin e hotelerisë, struktura te tjera akomodimi si dhe objekteve shërbyese e ndihmëse. Objekte me destinacion rezidencial dhe administrimi i tyre. Operimi i Bareve, Beach Bareve dhe Plazheve.

**NENI 5**

## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 ALL (njeqind mije lek) dhe është i përbërë nga 1 (nje) kuotë.

Kapitali themeltar zotërohet si më poshtë:

- **Erald MATA** zotëron 1 (një) kuote që perfaqëson 100% (njeqind) të kapitalit, me vlerë nominale 100,000 ALL (njeqind mije).

## NENI 6
## ORGANET E SHOQËRISË

Organi i vetem Administrativ i shoqerise eshte Administratori i saj i vetem

- Z. **Agim ISAKU**, shtetas shqiptar, lindur me 06.08.1985 ne Lejçan, Diber e banues ne Tirane, Rruga "Don Bosko" Nd. 164, H. 2, Ap. 16, NjA Nr. 9, 1016, mbajtes i Leternjoftimit ID me Nr. 037085864 dhe me numer personal I50806008Q , madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

qe do te qendroje ne detyre per nje periudhe prej 5 vjetesh me te drejte rizgjedhjeje.

Administratori qendron ne detyre per periudhen e caktuar nga ortaket ne momentin e emerimit ose, ne mungese percaktimi, deri ne doreheqjen ose shkarkimin e tyre dhe mund te rizgjidhen. Nuk mund te emerohen ne detyren e administratorit dhe, nese jane emeruar, duhet te shkarkohen, personat te cileve u eshte hequr ose kufizuar aftesia per te vepruar, kane falimentuar ose u eshte ndaluar, edhe perkohesisht, e drejta per te ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese prane personave juridike, si rrjedhoje e nje vendimi penal.
Cdo emerim qe bie ndeshe me paragrafet e siperpermendur nuk do te konsiderohet si konflikt interesi nese mer votbesimin e te pakten 51% (pesedhjete e nje perqinde) te ortakeve.
Ne rast emerimi per nje afat te caktuar, detyra e tyre perfundon ne daten e asamblese se thirrur per miratimin e bilancit te vitit te fundit ushtrimor te mandatit te tyre.
Perfundimi i mandatit te administratorit per shkak te perfundimit te afatit ka efekt nga momenti i riformimit te organit administrativ.

## NENI 7
## LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8
## ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve, ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdheniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje si fillim me marrveshje mes palëve ose në të kundërt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 10**
**DISPOZITA FINALE**

Ky akt themelimi u hartua në katër njësi të barazvlefshme e njejta në gjuhën shqipe, u lexuan e u pranuan nga ortaku i vetem i shoqërisë, i cili autorizon Agim ISAKU-n (administratorin) për depozitimin e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit.

**ORTAKU THEMELUES**

**ERALD MATA**

Erald Mata